



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PARLAMENTAR

PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Nr. ____ prot

Tiranë, më ____ . ____ .2019

Lënda: Depozitohet projekt-vendim për miratim në seancë plenare

**Zotit Gramoz RUÇI
Kryetar i KUVENDIT**

Në cilësinë si deputet dhe Kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar, Ju përcjell:
PROJEKT-VENDIMIN “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 74/2018 “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”.

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është ngritur dhe funksionon në bazë të Nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Kuvendi me vendimin nr. 74/2018, ka miratuar me Vendim ngritjen e Komisionit të Pavarur, por pa parashikuar masën e shpërblimit për anëtarët e Komisionit dhe Kryetarin.

Administrata e Kuvendit ka hasur vështirësi në zbatimin dhe përcaktimin e masës së shpërblimit duke sjelle vonesa të pajustificueshme në raport me te zgjedhurit nga Kuvendi në këtë Komision. Për këto arsye, me projekt-vendimin bashkëlidhur propozoj ndryshimin e pikës X të vendimit duke plotësuar vendimin edhe me dispozitat për masën e shpërblimit të anëtarëve të komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Me respekt,

Ulsi MANJA
DEPUTET

KRYETAR I KOMISIONIT
TË ÇËSHTJEVE LIGJORE
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT